



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:042465

Datë: 04.04.2019

Numri i dokumentit: 00268991

P.nr.1/2018

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me Sek. Juridike Vjollca Bytyqi, ne lenden penale PP/II nr.2567-6/2016 të datës 14.12.2016, ndaj të pandehurit S. A. nga fsh. P. Komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 i Kodit Penal, në prezencë të prokurorit të PTH-së në Prizren Beqë Shala dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt.26.03.2019 mori publikisht shpallë dhe me date 02.04.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S. A., nga i ati N., e ëma D., e lindur S., i lindur me dt. 28.08.1985 ne fsh. P. Komuna Suharekë, ka të kryer shkollën mesme, i pa martuar, me profesion punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

ESHTE FAJTOR

Sepse me dt. 10.09.2016 rreth orës 14;20 minuta, ne fsh. T. Komuna Suhareke, rrezikon trafikun publik duke shkelur nenit 44 dhe 46 të Ligjit për siguri në komunikacion rrugor dhe vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës "Opell Frontera" me targa të regjistrimit 04-...-DI ngjyre të hirtë, në mënyrë të pasigurt merr veprim të kyçje nga oborri i shtëpisë në rrugë në këtë mënyrë me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet në pjesën e përparme të automjetin e udhëtarëve të markës "Mercedes" me targa të regjistrimit 04-...-EO me ngjyre të gjelbër të cilën e voziste i dëmtuari H. V., i cili në ato momente ishte duke lëvizur në rrugë, me që rast përpos dëmeve materiale në automjete lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari H. V., dhe atë ndrydhje (mbrejtje) të indeve të buta të regjionit të vithes (mollaqes) të këmbës së djathtë, lëndime këto të përshkruar me për se afërmi në mendimin e ekspertit mjeko ligjor dr. V. H. dhe dr. F. D., të dhënë me dt. 01.11.2016.

Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 i Kodit Penal i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 45, 73, KP si dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 365 të KPP-së, i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Në shumë prej 150 € (Njëqindepesëdhjetë) euro, të cilin dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari dënimin në të holla

nuk e paguan ne afatin e parapare, gjykata dënimin me gjobe do te ia zëvendësoi me dënim me burg ne kohëzgjatje prej 7 ditësh, duke e llogaritur me nga 20 € një dite burgimi.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te shpenzimeve te ekspertizës se komunikacionit te paguaj shumen prej 40.88 euro, ne emër te ekspertizës mjeko-ligjore shumen prej 20 euro, ne emër te kompensimit te viktimave te krimit shumën prej 30 euro, si dhe paushallin gjyqësor ne shume prej 20 euro, te gjitha këto pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: H. E. V. nga fsh. T. Komuna Suharekë, udhëzohet qe kërkesën pasurore-juridike, ta realizoje ne kontest te rregullt civil

A r s y e t i m

PTH. në Prizren me aktakuzën S. A. nga fsh. P. Komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 i Kodit Penal, aktakuzën të cilën gjate shqyrtimit fillestar e ka përfaqësuar, prokurori i shtetit Beqe Shala, i cili në tërsi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP, ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestare nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 i Kodit Penal, andaj gjykata ka vendosur se i akuzuari është fajtor dhe i shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka pranuar fajësinë ne mënyrë vullnetare, veprën penale nuk e ka kryer me dashje por nga pakujdesia, është hera e pare qe bie ndesh me ligjin, kurse rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori ne kuptim te nenit 452 par., 1 te KPP.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP .

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.